

Ndihmë për azilkërkuesit në Bristol dhe Gloucestershire-in e Jugut

Ky informacion do të jetë në dispozicion i përkthyer në gjuhën arabe, somaleze, kurde sorani, pashto, perse, urdu, shqipe, bengaleze, frënge, mandarin dhe vietnameze. Përkthimet janë këtu

<https://www.bristolrefugeerights.org/how-we-help/i-need-help-i-start/>

ose janë në dispozicion tek organizatat e Bristolit të radhitura më poshtë.

Shërbimet në Bristol kanë ndryshuar për shkak të koronavirusit, i cili shkakton sëmundjen e quajtur Covid-19.

Nëse nuk ndiheni mirë, ose mendoni se keni simptoma të Covid-19, **MOS shkoni te mjeku i përgjithshëm ose në farmaci**, pasi kjo ka më shumë të ngjarë që të përhapë virusin.

Në vend të kësaj, telefononi në numrin 111 Mund të kërkonti një përkthyes. Ose shkoni këtu:

<https://111.nhs.uk/>

Informacioni i përkthyer lidhur me koronavirusin është këtu:

<https://www.doctorsoftheworld.org.uk/coronavirus-information/#>

Rregullat e qeverisë dhe këshillat e NHS-së për atë që duhet të bëjmë gjatë këtij shpërthimi epidemie janë këtu:

<https://www.gov.uk/coronavirus>

<https://www.nhs.uk/conditions/coronavirus-covid-19/>

Shërbime të mbështetjes për azilin të Bristolit

Të gjitha shërbimet e vizitave pa rezervim dhe ballë për ballë tek ABC, Borderlands, Bristol Hospitality Network (Rrjeti i Mikpritjes i Bristolit), Bristol Refugee Rights (të Drejtat e Refugjatëve të Bristolit), Kryqi i Kuq, Bristol Hospitality Network (Rrjeti i Mikpritjes i Bristolit) dhe Refugee Women of Bristol (Gratë Refugjate të Bristolit), janë mbyllur derisa të jetë e sigurt që të hapen sërish.

Shërbimet do të përpiqen t'ju ndihmojnë përmes telefonit, mesazheve dhe emailit. Meqenëse situata po ndryshon shumë shpejt, ne do të vendosim përditësime në uebsajt ose faqet tona në Facebook.

Solidariteti/mbështetja për skamjen do të vazhdojë si tani: ne po punojmë së bashku për të gjetur mënyra që ta ofrojmë këtë pa takime ballë për ballë.



Borderlands <https://www.borderlands.uk.com/>

Dërgoni mesazh me tekst ose telefononi në 07713 695 845 dhe lini emrin dhe numrin tuaj të telefonit.

Mbështetja jonë e këshillimit do të vazhdojë të funksionojë përmes telefonit dhe medieve sociale.



Aid Box Community <https://www.aidboxcommunity.co.uk/>

Telefononi në 0117 336 8441

Aid Box Connections mund t'ju lidhë me një anëtar të ekipit të ABC-së, i cili do të mbajë kontakte të rregullta.

Në rast urgjence, ne do të përpiqemi t'ju ndihmojmë me mbështetje praktike. Kjo mund të jetë një pako me ushqime, artikuj të kujdesit vetjak ose marrje e recetës.

Ju mund të referoheni për këtë shërbim nga çdo organizatë e cila mund të plotësojë një formular referimi për ju. Formulari është këtu <https://www.aidboxcommunity.co.uk/covid-19response>



Bristol Hospitality Network (Rrjeti i Mikpritjes i Bristolit) <https://www.bhn.org.uk/>

Telefononi, dërgoni mesazhe me tekst ose WhatsApp në **07561 391 353** ose **07934 341 391**

Nëse nuk merrni përgjigje, lini një mesazh me emrin dhe numrin tuaj të telefonit.
Do t'ju telefonojmë ne.

Emaili i ekipit të ndihmës elinor@bhn.org.uk

Jemi të mbyllur për referime të reja pritëse. Mbështetja për anëtarët ekzistues dhe të ftuarit do të vazhdojë.



Bristol Refugee Rights (të Drejtat e Refugjatëve të Bristolit)

<https://www.bristolrefugeerights.org/>

Shërbimi i këshillimit - Telefononi, dërgoni mesazhe me tekst ose WhatsApp në 07526 352 353

email advice@bristolrefugeerights.org

Ne mund të këshillojmë dhe të ndihmojmë me kërkesat për mbështetje me azilin (Ministria e Brendshme për paratë dhe strehimin), ndryshimet aktuale në kërkesat për azil dhe proceset e azilit e referimin tek të pastrehët dhe shërbimet e tjera.

Ne do të përpiqemi të jemi të hapur çdo ditë nga e hëna në të premten.

Nëse nuk merrni përgjigje, lini një mesazh me emrin dhe numrin tuaj të telefonit. Do t'ju telefonojmë ne.

Ne mund të sigurojmë një përkthyes. Ju lutemi të na thoni gjuhën tuaj.

Kërkesa të përgjithshme dhe informacione 07846 332 172

Mbështetja e Refugjatëve nga Kryqi i Kuq

<https://www.redcross.org.uk/get-help/get-help-as-a-refugee>

Telefononi, dërgoni mesazhe me tekst ose WhatsApp në 07739 863 036 / email
refugeeservicebristol@redcross.org.uk

Ne do të përpiqemi të jemi në dispozicion në çdo ditë të javës. Nëse nuk merrni përgjigje, lini një mesazh ose na shkruani dhe një punonjës social do t'ju kontaktojë.

Ju lutemi të na thoni emrin tuaj ose të personit në emrin e të cilit po telefononi, numrin e telefonit dhe arsyen e telefonatës.



Refugee Women of Bristol (Gratë Refugjate të Bristolit)

Telefononi në 0784 578 9482 / email info@refugeewomenofbristol.org.uk

Ne ofrojmë mbështetje emocionale për gratë që përjetojnë dhunë në familje, dhe bashkëpunojmë me Next Link; interpretim të informacionit të përditësuar nga qeveria dhe NHS-ja; mundësinë e vëmendjes mjekësore për anëtarët tanë. Ne po punojmë me rrjetin tonë të grave më të stabilizuara për të mbështetur ato që janë më të izoluar.



Project Mama (Projekti Mamaja)

<https://projectmama.org/>

Do të synojë që të shpërndajë pelena, nëse ka në dispozicion, për nënat e reja në nevojë. Ju mund të referoheni nga çdo organizatë e cila mund të plotësojë një formular referimi për ju. Formulari është këtu [Project MAMA Covid 19 response Nappy & Essential Items request form](#)